



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 232/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr. REF-86644-02-10-2021 me objekt: “Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II”, me fond limit: 81 666 555 lekë pa TVSh zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bajrami N” ShPK & “Gele Zani” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK
Lagjia: “Sporti” Gramsh

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Bulevardi Kryesor “10 Korriku”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të ankimuesit.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.02.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr. REF-86644-02-10-2021 me objekt: “Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II”, me fond

limit: 81 666 555 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Në datën 23.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 01.04.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Elda -VI” ShPK. pa ofertë ekonomike
2. Boe “Meteo” ShPK. & “Shëndelli” ShPK. & “Jubica” ShPK. 65.327.480 lekë, skualifikuar
3. “Vëllezërit Hysa” ShPK. 69.619.872 lekë, skualifikuar
4. Boe “ekonomikë “Bajrami N” ShPK & “Gele Zani” ShPK 79.994.441 lekë, kualifikuar
5. Boe “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK 81.231.740 lekë, skualifikuar
6. Boe “Viante Konstruksion” ShPK. & “Fusha” ShPK. & “Llazo” ShPK. 82.081.701 lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 01.04.2021 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Me anë të Akt marrëveshjes së bashkëpunimit nr.1410 rep, nr.415 kol datë 22.03.2021 është krijuar bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK , ku është parashikuar dhe përqindja e pjesëmarrjes , konkretisht “Inerti” ShPK 80 % , “Fled” ShPK 10% dhe Jubica” ShPK 10%. Por ky bashkim operatorësh nuk ka dorëzuar preventivin e ndarjes së punimeve që do të kryejë secili anëtar në bazë të përqindjes së marrë përsipër në akt marrëveshje.

Anëtari “Fled” ShPK, Shtojca 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut te punimeve”, nuk është paraqitur dhe plotësuar sipas formatit të DST-së të miratuar nga APP.

Anëtari “Inerti” ShPK , ka plotësuar gabim “Deklaratë për paraqitje Oferte të Pavarur”, ku në pikën 6 të kësaj deklarate ka deklaruar se “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, ndërkohë që në këtë procedurë merr pjesë si bashkim operatorësh ekonomikë dhe duhet të plotësoje germën “b”.

Anëtari “Klajger Konstruksion” ShPK, ka plotësuar gabim “Deklaratë për paraqitje Oferte të Pavarur”, ku në pikën 6 të kësaj deklarate ka deklaruar se “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë

dakord me asnjë konkurrent tjetër”, ndërkohë që në këtë procedurë merr pjesë si bashkim operatorësh ekonomikë “dhe duhet të plotësojë gërmën “b”.

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar “Për impiantet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport testimet për materialet si më poshtë: - Raport-Testimin e materialeve Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012. - Raport-Testimin e materialeve Rërë e Larë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012. - Raport-Testimin për mostrën e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1 : 3 2009. - Raport-Testimin për ujin e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 1008:2002. Testimet e mësipërme duhet të jenë bërë nga një Laborator i Akredituar konform S SH ISO/EN 17025:2006 Raporti i testeve duhet të jetë sipas standardeve në fuqi bazuar në ligjin ligjin Nr. 9290, datë 07/10/2004 “Për Produktet e Ndërtimit” Raportet e testimit duhet të jenë realizuar në 6-shtë mujorin e fundit. BOE ka dorëzuar raportet e testimit të vitit 2019 , dhe jo 6(gjashtë) muajt e fundit siç është specifikuar në DST, vetëm testimi i ujit te betonit është brenda këtij afati. Gjithashtu nuk ka dorëzuar Raport-Testimin për mostrën e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1 : 3 2009 si dhe certifikatën e akreditimit të laboratorëve sipas këtij standardi.

Të gjitha mjetet e deklaruar nga anëtari “Inerti” ShPK në shtojcën” Mbi disponimin e makinerive “ dhe folderin me emërtimin “Varaku Kontratë qiraje Part 1” dhe “Varaku Kontratë qiraje Part 2”, mbi bazën e kontratës së qirasë nr.Rep 128 , datë 16.01.2019 , konsiderohen të padisponueshme pasi ka përfunduar afati i dhënies me qira (2 vjeçar) më datë 16.01.2021 si dhe nuk specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Në pikën 15 “Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, është kërkuar: “Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj” OE “ Inerti” ShPK ka paraqitur shtojcën e mjeteve me qira ku të gjitha kontratat nuk janë të vlefshme pasi nuk specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, duke mos përmbushur kështu kushtin që “.....Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. → BOE nuk ka paraqitur, së bashku me preventivin analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës dhe siç parashikohet në pikën 17 të Kriterëve të Kualifikimit . mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

OE “Inerti” ShPK për të gjithë manovratorët dhe shoferët nuk ka dorëzuar dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente në kundërshtim me pikën 5/d të kriterëve të kualifikimit në të cilën është kërkuar “Për punonjësit shoferet e paraqiten dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe dëshmi drejtimi, ndërsa për punonjësit manovratorë te paraqiten dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe dëshmi te aftësisë profesionale dhe dëshmi drejtimi”.

OE “Klajger Konstruksion” ShPK për të gjithë manovratorët dhe shoferët nuk ka dorëzuar dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente në kundërshtim me pikën 5/d të kriterëve të kualifikimit në të cilën është kërkuar “Per punonjesit shoferet e paraqiten dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe dëshmi drejtimi, ndersa per punonjesit manovratorë te paraqiten dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe dëshmi te aftësisë profesionale dhe dëshmi drejtimi”.

II.5. Në datën 08.04.2021, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe kualifikimin e bashkimit të operatorëve lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bajrami N” ShPK & “Gele Zani” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit duke argumentuar si më poshtë vijon:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "INER TI" ShPK & "FLED" ShPK & "Klajger Konstruksion" ShPK ka shprehur interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) me datë 11.02.2021, me autoritet kontraktor Bashkia Gramsh, me objekt: "Rikonstruksion i rruges automobilistike Skenderbegas, Loti II", me Nr. REF- 86644-02-10-2021, zhvilluar në datën 23.03.2021 Ora:10:00 nga autoriteti Juaj kontraktor. Pasi u njohem me klasifikimin e bërë nga Autoriteti Kontraktor dhe arsyet e skualifikimit, Boe "INERTI" ShPK & "FLED" ShPK & "Klajger Konstruksion", në bazë të nenit 63 të ligjit Nr. 9643 "Për prokurimin publik", i ndryshuar paraqet ankesën drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar rivlersimin e procedurës ose anulimin e saj, për shkelje flagrante të ligjit nga zyrtaret e komisionit të vlersimit të ofertave.

Per sa i perket skualifikimit mbi ndarjen e punimeve, ju bejme me dije se:

Lidhur me pretendimin e AK që mungon preventivi i ndarjes së punimeve në kontratë sipas ndarjes së % në kontratë bashkepunimi, theksojmë që bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është përcaktuar qartësisht që para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. ...

Në Kreun VIII, neni 74 pika 2 këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurorë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokuror duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi.....”, ndërsa në pikën 3 parashikohet : “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.”.

Në rastin konkret nga ana jonë është cituar në kontratë që çdo shoqëri pjesë e BOE merr përsipër të kryejë respektivisht 80%-10%-10% të të gjithë zërave të punimeve dhe jo të zërave konkret.

Forma e bashkepunimit është në vullnetin e lire të paleve, mbështetur në kapacitetet teknike dhe financiare të gjithësecilit. Për sa kohë janë përmbushur të gjithë elementet që kërkojnë të mbajë kjo kontratë bashkepunimi sic është firma "përfaqësuese, dhe ndarja e % respektive, atëherë ky kriter konsiderohet i përmbushur nda ana jone. Bashkëngjitja e një preventivi me ndarjet e punimeve nuk ka qenë ndër kërkesat e parashtruara në DST dhe mbi të gjitha në rastin konkret ku punimet do realizohen teresisht nga të 3 operatorët në bazë të % të marra përsiper nga gjithësecili, nuk mund të flasim për ndarje zërash.

Gjithashtu siç theksuam dhe me siper, per aq kohe sa ne marreveshje bashkepunimi jane permendur te gjithë elementet e kerkuar ne VKM dhe ne DST atehere AK nuk mund te pretendoj pavlefshmerine e kesaj marreveshjeje bashkepunimi.

Në nenin 66 pika 3 e VKM-së RrPP-sëpërcaktohet se:

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Ak mund te kishte kerkuar sqarim bashkimit te operatoreve ekonomike "INERTI" ShPK & "FLED" ShPK & "Klajger Konstruktion" ShPK mbi realizimin e ndarjes se punimeve dhe analizat e cmimeve referuar kontratës dhe prokures se bashkepunimit. Por ne rastin konkret ka menjanuar kete mundesi duke vijuar me shkeljet ligjore ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka shkelur parimet kryesore te Ligjit Nr. 9643,, date 20.11.2006 " Per prokurimin Publik" ku shprehet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Sa më sipër skualifikimi juaj nuk qëndron.

Për sa i përket skualifikimit mbi deklaratat ju bëjmë me dije se:

Në ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Skualifikimi i AK eshte qesharak dhe tendecioz, pasi fakti nese jane apo jo bashkim operatoresh kete e verteton me se miri:

Sistemi elektronik SPE ku krijohet elektronikisht bashkimi i operatoreve

Dokumentacioni i paraqitur ne sistem nga te gjithë operatoret

Kontrata e bashkepunimit e nenshkruar perpara noterit Prokuren e perfaqesimit e nenshkruar perpara noterit.

Prokurën e përfaqësimit e nënshkruar përpara noterit.

Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Per sa i perket skualifikimit mbi raportet e testimit, ju bejme me dije se:

Nga BOE jane paraqitur testet e kryera ne vitin 2019 dhe te njejtat teste te kryera serisht ne vitin 2021 per materialet rere dhe granil sipas standardit SSH EN 933-1-20122. Lidhur me testimet per monstat e betonit deklarojme qe ato jane dorezuar nga ana jone sipas kerkesave te AK bashkengjitur dokumentacionit te fabrikes se betonit. Lidhur me Akreditimin e laboratorit qe ka realizuar testimet AK mund te kryeje cdo investigim te nevojshem duke kerkuar informacion lehtesisht te aksesueshem per akreditimin ose jo te te ketij te fundit, per aq kohe sa pretendon qe ky laborator nuk eshte i akredituar.

I gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomike per te permbushur kete kriter eshte i sakte dhe i vlefshëm. AK te rishikoje dokumentacionin dhe pastaj te dale ne perfundime.

Sa me siper pretendimi juaj nuk qendron

Sa i takon pretendimeve tuaja mbi mjetet.

Pike se pari Autoriteti Kontraktor në vendosjen e ketij kriteri ka shprehur qartazi shkeljet ligjore flagrante. Autoriteti Kontraktor nuk mund te vendose si kriter "kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri në perfundimin e plote te punimeve," pasi në zbatim të Kodit të Procedurave Civile marrëdhëniet midis palëve në një kontratë përfundojnë ose rinovohen pasi ajo të ketë mbaruar afatin e saj kontraktual. Si e tillë kjo kërkesë është në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi operatorët ekonomikë nuk mund të bëjnë rinovime kontratash qiraje të mjeteve për të mbuluar periudhën e realizimit të objektit që prokurohet, pa mbaruar afati i kontratës aktuale.

Detyrimi kontraktual qe do kete oe fitues me AK do te lidhet nepermjet kontrates se punimeve, dhe se deri në përfundimin e punimeve ai është i detyruar të mbajë të gjithë kapacitetin të cilin ai e ka shprehur në fazën e tenderimit, në rastin konkret ai medoemos do të rinovojë të gjitha kontratat e qirasë. Pikë së dyti një kontratë qiraje është e vlefshme edhe nëse nuk përmban objektin e kontratës që prokurohet.

Qëllimi që duhet të ketë AK është të vërtetojë disponimin e këtyre mjeteve nga operatorët ekonomikë për realizimin e punëve që do të kontraktohen dhe jot ë gjykoj mbi formën e kontratës së qirasë pasi forma është në vullnetin e lirë të palëve të mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurave Civile. Autoriteti Kontraktor nuk mund të pretendoj pavlefshmërinë e kontratës së qirasë për aq sa kohë ajo përmban elementët juridikë të domosdoshëm për tu konsideruar e tillë. Për aq sa kohë që kontratat janë ende në fuqi dhe efektet e tyre vazhdojnë të shtrihen në kohë atëherë ato janë tërësisht të vlefshme. AK duhet të merret me thelbin dhe jo përmbajtjen. Operatorët ekonomikë nuk mund të bëjnë rinovime kontratash qiraje të mjeteve për të mbuluar periudhën e realizimit të objektit që prokurohet, pa mbaruar afati i kontratës aktuale.

Gjithashtu të gjithë mjetet e paraqitura janë të dublikuara nga të gjithë operatorët çka do të thotë që me anë të bashkëpunimit të ndërsjelltë krijohet një suport teknik midis tyre. Nëse nga ju pretendohet pavlefshmëria e një kontrate qiraje prej afatit ato mjete mbulohe fare mirë nga operatorët e tjerë pjesë e bashkimit pasi shkëmbimi i ndërsjelltë i aseteve teknike është rregulluar ligjërisht në kontratën e bashkëpunimit. Ky kriter është diskriminues dhe ka disa vendime të KPP të cilat e hedhin poshtë këtë qëndrim. Kontrata e paraqitur nga BOE janë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kësaj kontrate. Kontrata është marrëveshje juridike e cila lidhet midis dy palëve për të përcaktuar një veprim juridik në rastin konkret qiranë e cila lidhet për një periudhë të përcaktuar dhe nuk ka asnjë arsye për të rilidhet me qëllim përfshirjen e objektit që prokurohet. Kontratat e mjeteve të paraqitura e mbulojnë të gjithë periudhën e realizimit të kësaj procedure ndaj janë të vlefshme. Por AK do të favorizojë atë oe për të cilin ka bërë marrëveshje paraprakisht.

Sa më sipër skualifikimi juaj është diskriminues në kundërshtim dhe shkelje me ligjin dhe nuk favorizon aspak konkurrencën e OE pjesëmarrës.

Referuar skualifikimit mbi specialistët.

BOE i ka permbushur nr e punonjesve te kerkuar me iqt ne total. Boe ka deklaruar ne kontrate dhe prokuren e bashkepunimit se marrin persiper te realizojne kete kontrate duke bashkuar te gjitha kapacitetet ekonomike teknike dhe juridike si nje shoqeri e tere. Perkatesisht nuk ka mangesi ne nr punonjesish te kerkuar ne dst. Por AK i leverdis me shume te skualifikojte shoqerite ne menyre flagrante ne shkelje me ligjin se sa te procedojë me nje konkurrim te drejte.

Gjithashtu vlen të theksohet dhe fakti që Deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik janë deshmi që lidhen për përdorimin e pajisjeve elektrike. Në rastin konkret jemi përballë rikonstruksionit të një rruge ekzistente dhe jo të ndertimit të impianteve elektrike. Këto certifikime merren mbi skemën e certifikimit të personave që përdorin pajisje elektrike bazuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet Pajisjet dhe Instalimet elektrike, miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës. Nuk mund të gjykohej kapaciteti profesional i një shoferi dhe manovratori nga dëshmia e sigurimit teknik për linjat elektrike. Çdo kërkesë e AK ka qenë tendencioze dhe favorizuese për firmën e kualifikuar.

Në këtë rast skualifikimi është diskriminues dhe në shkelje flagrante me ligjin. Është bërë me qëllim dhe me synime të qarta.

Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Gjithashtu duke ju referuar klasifikimi ju bëjmë me dije se:

Operatori ekonomik që AK ka shpallur fitues ka mangësi në dokumentacion dhe nuk i përmbush te gjitha kriteret e përcaktuar në DST.

Nëse AK do të jete kerkues në dokumentacion ashtu si është me BOE "INERTI" ShPK & "FLED" ShPK & "Klajger Konstruksion" ShPK, atehere ashtu duhet të jete për gjithë pjesëmarrësit e kesaj procedure, pa bere favorizime paraprake.

Në LPP neni 46 përcaktohet se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në VKM-në RrPP neni 26 pika 5 dhe pika 8 përcaktohet se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Së pari OE i shpallur fitues nga AK “Gele Zani” ShPK është i angazhuar me kapacitete ekonomike teknike me Bashkinë Gramsh në procedurën me objekt “Rikonstruksioni qendrës multifunkionale në Gramsh me AK Bashkinë Gramsh”. Ky oe nuk ka kapacitetet e duhura të lidhura për të përmbushur këtë kontratë. Ndonëse e tillë AK e ka shpallur fitues në shkelje dhe duke favorizuar atë.

Së dyti kjo shoqëri është krijuar 01.11.2018 çka bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST. Si e ka përmbushur ky operator xhiron vjetore 3 vitet e fundit? Si e ka përmbushur ky operator paraqitjen e bilanceve të 3 viteve të fundit?

Së treti shoqëria “Bajrami N” ShPK nuk ka paguar taksat vendore për bashkinë Përrenjas. Kontratë e cila është lidhur në vitin 2020 dhe gjithashtu është shpallur fitues në dy objekte të prokuruar respektivisht nga Bashkia Tiranë Fondi Shqiptar i Zhvillimit në të cilat ka angazhuar

të gjitha asetet teknike që kjo firmë disponon si dhe stafin inxhinierik duke e bërë të pamundur realizimin e kontratës procedurës objekt ankimi.

Është e dukshme e qartë që AK dhe Anëtarët e KVO-së z. A. Sh.; z. A.C.; Z. A. Sh.; kanë favorizuar fituesin pasi kështu ju leverdis anëtarëve. Është e dukshme që fituesi nuk plotëson ato mangësi për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK është skualifikuar nga e njëjta KVO.

Sa më sipër kërkojmë nga AK të kualifikojë ofertën tonë ose të anulojë procedurën për mangësi në dokumentacion nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Nëse AK nuk merr për bazë këtë ankesë atëherë ne e konsiderojmë si një procedurë prokurimi ku nuk zbatohet legjislacioni në fuqi për procedurat e prokurimit publik, ku fituesi është caktuar paraprakisht. I kërkojmë APP-së e vënë në dijeni me këtë ankesë të marrë masa të menjëhershme për fillimin e procedurave të hetimit administrative ndaj anëtarëve të KVO-së z. A. Sh.; z. A.C.; Z. A. Sh.; për skualifikimet e bëra në shkëlqje të lpp-së dhe Rekomandimeve tuaja, të vendosura në dst si dhe duke shkelur parimet e LPP-së. I kërkojmë Kontrollit të Lartë të Shtetit të marrë masat e duhura për parandalimin e rasteve korruptive dhe abuzive me procedurat e prokurimit publik. Rast flagrant i abuzimit me fondet e buxhetit të shtetit.

I kërkojmë Task Forcës ndërinstitucionale Antikorrupsion të ndërhyjë menjëherë për ngritjen e grupit të auditimit për të ndaluar rastet flagrante korruptive dhe abuzimet e ligjit.

I kërkojmë Prokurorisë së Përgjithshme të nisë menjëherë hetimet mbi anëtarët e KVO-së Kryetarit të Bashkisë dhe oe të shpallur fitues. Nëse AK nuk pranon ankesën tonë atëherë ne do ti drejtohem KPP-së dhe të gjitha instancave të drejtësisë. [...]

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.1340/2 prot, datë 16.04.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK duke e refuzuar ankesën e tij në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 15.04.2021 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 16.04.2021 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK ka paraqitur përsëri ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit në datën 15.04.2021.

II.9. Njëpërmjet shkresës nr. 1539/1 prot., datë 23.04.2021, protokolluar me tonën në datën 26.04.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen: “Të gjitha mjetet e deklaruarat” nga anëtari “Inerti” ShPK në shtojcën” Mbi disponimin e makinerive “ dhe folderin me emërtimin “Varaku Kontratë qiraje Part 1” dhe “Varaku Kontratë qiraje Part 2”, mbi bazën e kontratës së qirasë nr. Rep 128 , datë 16.01.2019 , konsiderohen të padisponueshme pasi ka përfunduar afati i dhënies me qira (2 vjeçar) më datë 16.01.2021 si dhe nuk specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 12 të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, pika 2.3. e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar si më poshtë:

15.Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve ne pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën.

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Eskavator me zinxhire	Cope	2	Në pronësi ose me qira
2.	Eskavator me zinxhire me kapacitet 9 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3.	Eskavator me goma	Copë	5	Në pronësi ose me qira
4.	Grejder	Copë	2	Në pronësi ose me qira
5.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 30 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-18 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
8.	Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9.	Kamionçinë me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 Ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
10.	Gurëthyes, frontoje	Copë	1	Në pronësi ose me

				<i>qira</i>
11.	<i>Nyje Inerte me QKL</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
12.	<i>Fabrike asfalti me QKL</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
13.	<i>Impiant betoni me QKL</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
14.	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
15.	<i>Asfalo-shtrues</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
17.	<i>Rrul gome-hekur 18 Ton</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
18.	<i>Rrul gome-hekur 12 Ton</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
19.	<i>Rrul hekur – hekur 3 ton</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
20.	<i>Rrul asfalti me gomë – gomë kapaciteti 4 ton</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
21.	<i>Rruli hekur-hekur me pak se 1Ton</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
22.	<i>Gjysem rimorkio per transport mjetesh</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
22.	<i>Kompresor</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
23.	<i>Autobot uji</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
24.	<i>Freze asfalti</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
25.	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
26.	<i>Autopompe Betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
27.	<i>Aparat topogjeodezik me GPS</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
28.	<i>Mjet autovinç</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
29.	<i>Fadromë Kovë përpara dhe mbrapa</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
30.	<i>Depozite Uji 10.000 Litra</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
31.	<i>Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

32.	<i>Vibrator Betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
33.	<i>Mini Fadrome</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit si me poshte:

- *kokore minimum 50 (njqind) cope,*
- *jeleke minimum 50 (njqind) cope,*
- *fikese zjarrit e levizshme minimum 5 (pese) cope,*
- *komplet i ndihmes se shpejt minimum 5 (pese) cope,*
- *karroca dore minimum 10 (dhjete) cope.*
- *Kullë ndriçimi - minimumi 1 copë*
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesine e mjetit:*
 - *certifikatën e pronësisë;*
 - *leja e qarkullimit;*
 - *certifikatën e kontrollit teknik;*
 - *siguracionin;*
 - *leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese;*
- *ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te jete per te gjithë periudhen e realizimit deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qira me qellim verifikimi).*
- *Per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit duhet te paraqese planvendosjen dhe projektin teknologjik.*

❖ *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi, me qira ose të ketë kontratë noteriale furnizimi për:*

a) Impiant prodhim Betoni me QKL

b) Impiant prodhim Inertesh me QKL

Për sa më sipër, OE duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, të marrjes me qira, apo kontratën noteriale të furnizimit, të shoqëruara me leje mjedisore nga QKL si më poshtë:

-QKL - Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B "Impiant betoni, për prodhimin e produkteve të betonit", të shoqëruar me planvendosjen e Impiantit, monitorimin mjedisor .

-QKL - Leje Mjedisi, kodi III.1.B "Impiant Inertesh"

❖ *Për impiantet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport-testimet për materialet si më poshtë:*

- Raport-Testimin e materialeve Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.

- Raport-Testimin e materialeve Rërë e Larë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.

- Raport-Testimin për mostrën e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1 : 3 2009.

- Raport-Testimin për ujin e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 1008:2002.

Testimet e mësipërme duhet të jenë bërë nga një Laborator i Akredituar konform S SH ISO/EN 17025:2006

Raporti i testimeve duhet të jetë sipas standardeve në fuqi bazuar në ligjin ligjin Nr. 9290, datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit" Raportet e testimit duhet të jenë realizuar në 6-shtë mujorin e fundit.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Inerti" ShPK & "Fled" ShPK & "Klajger Konstruksion" ShPK, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive ndërmjet shoqërisë "Inerti" ShPK & "Fled" ShPK & "Klajger Konstruksion" ShPK, nga ku shoqëria "Inerti" ShPK. merr përsipër se do të kryejë punimet për çdo zë preventive në masën 80 %, shoqëria "Fled" ShPK. merr përsipër në masën 10 % dhe shoqëria "Klajger Konstruksion" ShPK. merr përsipër në masën 10 %. Gjithashtu, është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Inerti" ShPK. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

I. Shoqëria "Inerti" ShPK. si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Inerti" ShPK & "Fled" ShPK & "Klajger Konstruksion" ShPK ka paraqitur:

Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku janë deklaruar ndërmjet të tjerave edhe këto mjete:

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:INERTI SHPK

- **Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknikedhe asete tëtjera fizike për tërealizuar kontratën me objekt: Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II;**
- Mjetet Nuk jane te angazhuara ne asnje procedure tjeter dhe do jene te disponueshme gjate gjithe zhvillimit teobjektit.
- Mjetet ne pronesi ndohen ne kantierin e shoqerise ne Tirane, ne Krugen 5 Maji. Mjetet e marra me qira ndodhen ne kantieret respektive te qiradhenesve. Autoriteti Kontraktor ne cdo kohe mund te verifikoj vendodhjen dhe disponueshmerine e tyre.
- Per transportin e mjeteve teknologjike do perdoret Traileri i vene ne dispozicion nga anetari I Bashkimit te Operatoreve Fled Shpk

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Tëtjera
KAMIONCINE 3.5-5 T	AA260GC	TRDB1530113	WDB9720111K513113	
KAMIONCINE 3.5-5 T	AA644LH	TRDA1711615	WDB9043221P585780	
RRUL ME VIBRIM		R9046,N5396		FATURE ZHDOGANIMI I 29.06.201
Mjete dhe paisje				Fatura nr 612, 89,41,33 67,3438, 10013, 45, 47, 213280257, 47, 33
Rrul				Bomag
Freze				Fatura 63
Kontenier				Fatura 599

Dhe

Me qera					Afati i kontratës sëqerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes	Nr. Shasisë sëmjetit	Nr. Kont së qerasë(noterisë)	

		sëqarku llimit tëmjetit			
Eskavator Me Goma	Aemt71		6TI.00488	Rep. 4332 Kol. 1069	13.08.20
Autovinc	AA094DC	TRF04981 2	67601215180194	Rep.1684 Kol.1100	29.05.20 29-05-20
Autovinc	AA093DC	TRF049 0012	67401315185201	Rep.1684 Kol.1100	29.05.20 29-05-20
Autobot	AA990GY				PA AF/
Kulle Ndricimi				Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Asfaltoshtruese			RR031	Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Autobitumatrice	AA673RE			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Rrul Bitelli				Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Rrul Ham				Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Rrul Dynapac				Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Rrul Dynapac i madh				Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Greider	AIMT53			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Kamion	AA150UM			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Kamion	AA348MB			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Kamion	AA945JI			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Kamion	DR0059F			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Kamion	DR2419F			Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Fabrike Asfaltobetoni			RE SIM CB 160	Rep.128 16.01.2019	Nga 16.01.2019 me afatdy vjec
Rrul 2 cope			Ham Hd 110	Rep.3079, Kol.1522	Nga 23.09.2019 me sfat dy vjec
Rrul			GRW 15	Rep.3079, Kol.1522	Nga 23.09.2019 me sfat dy vjec
Rrul			HD12VV	Rep.3079, Kol.1522	Nga 23.09.2019 me sfat dy vjec
Rrul				Rep.2413, Kol.1483	Me afat te pacaktu
fadrome	ACMT35				
Autobetoniere	TR9453P			Rep.1155, Kol.925	Nga 18.02.2020 me afat nje vjec
Autopompe	AA815UA			Rep.1155, Kol.925	Nga 18.02.2020 me afat nje vjec
Fabrike Betoni				Rep.1139, Kol.917	Nga 18.02.2020 me afat nje vjec
Eskavator 9 T	JCB8085			Rep.1409, Kol.414	Nga 122.03.2021 me afat dy vjec
Eskavator Me Zinxhir	CAT AIMT33		3yz01062	Rep. 2932 Kol. 2152	10.11.20
Eskavator Me Zinxhire		CX460LC		Rep. 1313 Kol. 600	Nga 16.04.2019 me afat 5 vjec
Eskavator Me Zinxhire	320BLN	32Z01062		Rep. 2974 Kol. 2194	11.11.2016 me afat te pacaktu
Graider	AFMT65			Rep. 2656 Kol. 629	03.06.2020 me afat dy vjec
Eskavator	AEMT17			Rep. 2656 Kol. 629	03.06.2020 me afat dy vjecar

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONAL KONTAKTIT (për këtë ofertë)


Emri:

Adresa:

Nr. Telefoni:

Faks:

E-mail:



- Referuar Deklaratës së mësipërme ndërmjet të tjerave, është paraqitur dokumentacion për mjetet e deklaruar si më poshtë:

Kontratë nr. 128 Rep datë 16.01.2019 në të cilën (citojmë): “[...]qiradhënësi “VarakuE” ShPK ka në pronësi të saj këto mjete:

Mjet Greder marka marini tipi 251.

Mjet ATV (autobitumatriçe) marka iveco fiat tipi 150 e 18.

Mjet MT (ESKAVATOR ME GOMA) marka hitachi tipi cba 999.

Mjet makineri vijëzimi

Mjet KULLË NRIÇIMI ME GJENERATORË ME 6 PROZHEKTORË

Rrula copë 4

Asfaltrshtruese marini

Kamiona copë 5 +impiant asfaltbetoni .

Pronësinë mbi të cilin e vërtetojnë dokumentat bashkëngjitur kësaj kontrate qiraje.

Qiradhënësi deklaron se këto mjete ia jep me qira shoqërisë “Inerti” ShPK për një afat dy vjeçar nga lidhja e kontratës[...]”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.*

III.1.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet***

të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.7. Referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK kanë përcaktuar përqindjen që do të kryejë secili anëtar i bashkimit ku rezulton se “Inerti” ShPK merr përsipër se do të kryejë punimet për çdo zë preventive në masën 80%, shoqëria “Fled” ShPK merr përsipër në masën 10% dhe shoqëria “Klajger Konstruksion” ShPK merr përsipër në masën 10%.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK, rezulton se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK i cili sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër realizimin në masën 80% të zërave të punimeve, për të provuar disponimin e makinerive ndër të tjera ka paraqitur një Kontratë Qiraje nr. 128Rep datë 16.01.2019 me anë të së cilës ka marrë me qira nga “Varaku E” ShPK mjetet si vijon:

Mjet Greder marka marini tipi 251; Mjet ATV (autobitumatriçe) marka iveco fiat tipi 150 e 18; Mjet MT (ESKAVATOR ME GOMA) marka hitachi tipi cba 999; Mjet makineri vijëzimi; Mjet KULLË NRIÇIMI ME GJENERATORË ME 6 PROZHEKTORË; Rrula copë 4; Asfaltrshtruese marini; Kamionë copë 5 +impiant asfaltbetoni; . Në këtë kontratë parashikohet shprehimisht se: ***Qiradhënësi deklaron se këto mjete ia jep me qira shoqërisë “Inerti” ShPK për një afat dy vjeçar nga lidhja e kontratës[...]***

Referuar datës së lidhjes së kontratës së qirasë 16.01.2019, KPP gjykon se sipas parashikimeve në kontratë e konkretisht afatit të lidhjes së saj (dy vjet) kontrata ka mbaruar efektet juridike në datën 16.01.2021. Ndërsa data e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi datë 23.03.2021. Në këtë kuptim KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK ka dështuar të paraqesë dokumentacion të vlefshëm në ditën e hapjes së ofertave sa i takon provueshmërisë së disponimit të makinerive pasi kontrata me afat 2 vjeçar lidhur me shoqërinë “Varku E” ShPK për marrjen me qira të mjeteve si më sipër cituar nuk mund të japë më pasojë juridike për shkak të përfundimit të efekteve të saj në datën 16.01.2021, e për pasojë nuk mund të konsiderohet e vlefshme.

Referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi numri i mjeteve të kërkuara nuk plotësohet nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit nëmasën 80%.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në

përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bajrami N” ShPK & “Gele Zani” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktues. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktues.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e konkurrimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë konkurruese.

Për rrjedhojë, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk legjitimohet.

III.4. Lidhur me çështjen administrative protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 620 datë 16.04.2021, KPP vëren se, janë ngritur të njëjtat pretendime si në çështjen administrative nr. 612 datë 15.04.2021, e cila u mor në shqyrtim në themel me arsyetimin si më sipër cituar. Për rrjedhojë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se tarifa e paguar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK për ankesën protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 620 datë 16.04.2021 duhet ti kthehet ankimuesit, pasi tarifa për marrjen në shqyrtim të ankesës është paguar për ankesën e protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 612 datë 15.04.2021.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr. 86644-02-10-2021 me objekt: “Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II”, me fond limit: 81 666 555 lekë pa TVSh zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inerti” ShPK & “Fled” ShPK & “Klajger Konstruksion” ShPK, për çështjen administrative protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 620 datë 16.04.2021.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 612Protokolli Datë 15.04.2021

Nr. 620Protokolli Datë 16.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri